



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**



**PROGRAMI I LËNDËS
GJUHË FRËNGE 4**

Ngarkesa: 3 kredite : 40 leksione /seminare

Viti akademik / semestri kur zhvillohet::Viti III: Semestri: I

Lloji i lëndës: Lëndë me detyrim/ B

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore: Ky modul kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe pjesëmarrje aktive nga studenti, duke u mbështetur në metodën interaktive të mësimdhënies. Metoda Alter Ego B2+ synon të thellojë kompetencat gjuhësore, komunikuese dhe kulturore në gjuhën frënge përmes materialeve autentike dhe teksteve informuese, përshkruese, shpjeguese e argumentuese. Qasja pedagogjike bazohet në vëzhgim, analizë dhe ndërveprim, duke zhvilluar aftësitë e komunikimit me shkrim e me gojë si edhe njohjen e kulturës franceze.

Objektiva specifike lëndore:

- Arritja e nivelit B2 në komunikim sipas parametrave të percaktuara nga Kuadri European i Perbashket per gjuhet;
- Aftësia për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në mënyrë të pavarur mbi tema të ndryshme të jetes së përditshme personale dhe profesionale;
- Aftësia për të përzgjedhur dhe përdorur fjalorin perkates mbi temat si shkolla, profesioni, argetimeve etj;
- Aftësia për të treguar një ngjarje në kohën e shkuar dhe për tv shprehur emocione, dëshira apo ndjenja të ndryshme nëpërmjet letrave personale;

Rezultate të pritshme:

- Aftësi komunikimi me gojë e me shkrim, aftesi per te kuptuar dhe lexuar tekste te ndryshme sipas parametrave te percaktuara per nivelin B2;
- Kompetenca shoqërore dhe qytetare: nxitja e punës në grup dhe sensibilizimi për tema të ndryshme sociale e kulturore;
- Kompetenca ndërkulturore: njohja e kulturave te ndryshme dhe e diversitetit kulturor.
- Të kuptojnë pikat kryesore të një diskutimi kur përdoret një gjuhë e qartë dhe standarde dhe nëse bëhet fjalë për gjëra të njohura në punë, shkollë, kohë të lirë etj.;
- Të jetë në gjendje të prodhojë një ligjërime të thjeshtë dhe koherente për tema të njohura dhe në fushat e tij të interesit